



VENDIMI DHE GJETJET

Data e miratimit: 19 qershor 2019

Numri i lëndës 2017-02

Zufe Miladinović

kundër

EULEX

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur më 19 qershor 2019, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaël METTRAUX, kryesues
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. Ronald HOOGHMSTRA, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2019,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa në këtë lëndë është regjistruar më 19 prill 2017.
2. Me shkresën e datës 20 prill 2017, Paneli ka njoftuar Misionin për regjistrimin e kësaj lënde në Panel.

3. Më 12 prill 2018, Paneli ka dërguar një deklaratë të fakteve dhe pyetjeve shëfës së Misionit (ShM) të EULEX-it Kosovë.
4. Më 22 maj 2018, ShM-ja ka dorëzuar përgjigjet e saja në Panel.
5. Më 10 janar 2019, parashtresat e ShM-së iu dërguan parashtresës së ankesës për komente. Ankuesja ishte ftuar të parashtronte parashtresa shtesë, nëse kishte, më së voni deri më 4 shkurt 2019. Ankuesja kërkoi më shumë kohë për t'u përgjigjur dhe për të dhënë informacion shtesë për Panelin. Ajo u përgjigj më 6 mars 2019. Në letrën e saj, ankuesja tregoi se ajo qëndronte pranë ankesës së saj, duke vënë në dukje ato çfarë ajo i sheh si kontradikta në parashtresat e ShM-së dhe kishte kërkuar që ankesa të shpallej e pranueshme.
6. Me një vendim të datës 27 mars 2019, Paneli e deklaroi çështjen si të pranueshme ([http://hrrp.eu/docs/decisions/2019-03-27%20Admissibility%20Decision%202017-02%20\(Red.\).pdf](http://hrrp.eu/docs/decisions/2019-03-27%20Admissibility%20Decision%202017-02%20(Red.).pdf)). Në atë vendim, Paneli i parashtroi një sërë pyetjesh palëve dhe kërkoi që të ofronin ndonjë përgjigje deri më 20 maj 2019. Pyetjet ishin si më poshtë:

i. Për Misionin:

- a. Para datës 3 dhjetor 2013 dhe "Hedhja poshtë e Raportit Penal", çfarë hapi(hapa) hetues kishte marrë Misioni për të sqaruar këtë rast? A ishin të informuar të afërmit e personave të zhdukur për këto përpjekje?
- b. A është ndërmarrë ndonjë hap për të hetuar këtë rast apo për të mbledhur informacion pas kësaj date?
- c. Pas pranimit të një letre nga ankuesi më 1 dhjetor 2015, a ka ndërmarrë ndonjë hap Misioni për të hetuar këtë rast? Nëse po, çfarë hapi(hapa)?
- d. Gjatë transferimit të dosjes së lëndës në institucionet e Kosovës, a ishte dërguar ndonjë material hetues tek autoritetet vendore në lidhje me këtë rast? A ishte informuar ankuesi për këtë transferim?
- e. A është duke e monitoruar Misioni këtë rast?

ii. Për ankuesen:

- a. A jeni në dijeni rreth ndonjë përpjekjeje nga autoritet vendore (të Kosovës) për të hetuar këtë rast?

- b. A ka bërë shkelje apo a ka kontribuar Misioni në shkeljen e të drejtave të ankueses sipas neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës? Nëse po, në çfarë mënyre?
 - c. Cilat janë pasojat personale, financiare dhe emocionale – që lidhen me zhdukjen e të afërmit tuaj?
7. Më 13 maj 2019, ankuesi i dërgoi përgjigjet e saj në pyetjet e Panelit. Më 20 maj 2019, ShM-ja i dërgoi Panelit një letër me përgjigjet e saj. Këto letra iu dërguan palës kundërshtuese për informacione.

II. PËRBËRJA E PANELIT

8. Pas dorëheqjes së një prej anëtarëve të tij të përhershëm dhe në pritje të zëvendësimit të tij, Paneli do të mbliidhet në këtë çështje vetëm me dy anëtarë në përputhje me rregullat 11 dhe 14 të rregullores së punës së Panelit.

III. FAKTET

9. Faktet e paraqitura nga ankuesja mund të përmbliidhen si më poshtë.
10. Ankuesja është bashkëshortja e z. Srboljub Miladinović.
11. Ankuesja deklaroi se më 25 qershor 1998, z. Srboljub Miladinović ishte larguar nga shtëpia e tyre në Reçan në komunën e Prizrenit për të udhëtuar me autobus për në Prishtinë. Autobusi ishte ndaluar pranë fshatit Carralevë nga persona të armatosur. Z. Miladinović ishte nxjerrë nga autobusi nën kërcënimin e forcës. Personat e armatosur ishin përpjekur të merrnin një person tjetër, V.I., me vete, por një grua në autobus kishte intervenuar dhe i kishte ndalë ata që ta merrnin V.I.
12. Ankuesja më vonë kishte mësuar nga V.I. se ata që e morën burrin e saj mendohej të ishin anëtarë të UÇK-së dhe se bashkëshortit të saj iu ishin mbyllur sytë dhe ishte lidhur para se të dërgohej në drejtim të Malishevës.
13. Në një raport të Njësisë së UNMIK-ut për Hetimin e Krimeve të Luftës (NjUKL) të datës 9 dhjetor 2004, të dhënë nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), doli që bashkëshorti i ankueses mund të ishte qëlluar gjatë rrëmbimit, përderisa përpiquej të arratisej, por se ai i kishte mbijetuar të shtënave.
14. Pas rrëmbimit të bashkëshortit të saj, ankuesja kishte kërkuar për të në gjithë Kosovën pa sukses. Në një moment në dhjetor 1998, ajo u përpoq të vizitonte një vend ku të burgosurit serbë pretendoheshin se ishin mbajtur peng, por pohon se asaj i është ndaluar hyrja në atë vend nga shefi i OSBE-së, Misioni i Verifikimit të Kosovës dhe stafi i tij. Dikur më vonë,

ankuesja dëgjoi nga një person i panjohur se bashkëshorti i saj ishte lidhur në një pemë në një fshat afër Lipjanit dhe pastaj ishte vrarë.

15. Ankuesi raportoi rrëmbimin dhe zhdukjen e bashkëshortit të saj në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë, OSBE, në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (ICTY) në Beograd dhe në Kryqin e Kuq Jugosllav. Përveç kësaj, ankuesja i bashkëngjiti ankesës së saj një raport penal drejtuar Prokurorit Ndërkombëtar të Prokurorisë Publike të Qarkut, Prizren.
16. Më 9 shtator 1998, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) hapi një kërkesë për ta kërkuar z. Miladinović. Emri i tij gjithashtu u paraqit në një listë të personave të zhdukur, të komunikuar nga KNKK-ja tek Policia e UNMIK-ut më 12 tetor 2001 dhe në një bazë të të dhënave të përpiluar nga Zyra e UNMIK-ut për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore (OMPF). Në listën në internet të personave të zhdukur që mirëmbahet nga Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur 3 (ICMP3) në lidhje me z. Miladinović në pjesët përkatëse shkruan si vijon: “Janë mbledhur mostra të mjaftueshme referimi” dhe “Nuk është gjetur përputhje me ADN-në”.
17. Ankuesja pohon se autoritetet nuk kanë bërë asgjë efektive për të gjetur bashkëshortin e saj për më shumë se dhjetë vite pasi ai është zhdukur.
18. Më 7 prill 2009, ankuesja ka parashtruar një ankesë pranë Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (PKDNj) të UNMIK-ut më 7 prill 2009. PKDNj-ja ka dhënë mendimin e vet më 1 shtator 2013 dhe në atë vendim shkruan si në vijim:

“Paneli (PSDNj-ja) thekson që zhdukjet e imponuara dhe ekzekutimet arbitrare përbëjnë shkelje serioze të të drejtave të njeriut, të cilat do të hetohen dhe ndiqen në të gjitha rrethanat. Paneli gjithashtu thekson që UNMIK-u si administrues territorial i Kosovës nga viti 1999 deri më 2008, kishte përgjegjësinë primare t’i hetojë në mënyrë efektive dhe t’i ndjekë ata që ishin përgjegjës për vrasje, rrëmbime apo zhdukje në rrethana kërcënimi me jetë. Dështimi për ta bërë këtë paraqet shkelje të mëtejme serioze të të drejtave të viktimave dhe më të afërmeve të tyre, në veçanti të së drejtës për ta ditur të vërtetën lidhur me çështjen.

Paneli thekson shqetësimet e PSSP-së që burimet joadekuate, veçanërisht në fillim të misionit të UNMIK-ut, e bënë të vështirë plotësimin e obligimeve të UNMIK-ut ndaj të drejtave të njeriut. Do të ishte normale që UNMIK-u t’i merr masat e duhura me qëllim që t’i ndalë shkeljet e theksuara dhe t’i korigjojë atë sa është e mundur me efektet nga kjo. Megjithatë, siç ka theksuar Paneli më lart (shih § 18), përgjegjësia e UNMIK-ut në lidhje me administrimin e drejtësisë në Kosovë përfundoi më 9 dhjetor 2008, me marrjen përsipër nga EULEX-i të kontrollit të plotë operacional në fushën e zbatimit të ligjit. Prandaj, UNMIK-u nuk është më në pozitë të merr masa që do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në hetime që ende janë në zhvillim e sipër pranë EULEX-it apo autoriteteve vendore.

Gjithashtu pas shpalljes së pavarësisë nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes të Kosovës, më 17 shkurt 2008 dhe më pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës më 15 qershor 2008, UNMIK-u ka pushuar së kryeri funksione ekzekutive në Kosovë, dhe ky fakt kufizoi aftësinë e tij për të siguruar korrigjim të plotë dhe efektiv të shkeljeve të kryera, siç kërkohet me parimet e vendosura në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut". Paneli konsideron se kjo situatë faktike nuk e liron UNMIK-un nga detyrimi tij për të korrigjuar sa më shumë që të jetë e mundur efektet e shkeljeve për të cilat është përgjegjës".

19. PKDNj-ja ka përfunduar, *ndër të tjera*, si vijon:

"Konstaton se ka pasur shkelje të obligimit procedural sipas nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

Konstaton se ka pasur shkelje të obligimit esencial sipas nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

Rekomandon që UNMIK-u të kërkojë nga EULEX-i dhe autoritetet e tjera kompetente në Kosovë të ndërmarrin të gjitha hapat e mundshëm për të siguruar që hetimi penal për zhdukjen e z. Srboljub Miladinović të vazhdojë në përputhje me nenin 2 të KEDNJ-së dhe që autorët të sillen para drejtësisë".

20. Në një datë të mëvonshme, ankuesja ka pranuar një letër nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP-ja) si në vijim:

"Pas shqyrtimit të mendimit dhe rekomandimeve të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut lidhur me ankesën e znj. Zufe Milladinović (lënda nr. 86/09), më datën 13 nëntor 2013 kam njoftuar Panelin tim këshillëdhënës për si në vijim:

Që në fillim dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për punën e Panelit dhe për rekomandimet e dhëna lidhur me ankesën në fjalë.

Lidhur me rekomandimin e parë, ashtu siç është rekomanduar nga Paneli, UNMIK-u do të vazhdojë të nxisë EULEX-in dhe autoritetet e tjera kompetente që të vazhdojnë të ndërmarrin të gjithë hapat e mundshëm për t'u siguruar që hetimet penale lidhur me zhdukjen e bashkëshortit të ankueses të vazhdohen dhe që kryerësit e krimeve të vihen para drejtësisë.

Lidhur me rekomandimin e dytë të Panelit, më vjen keq për mungesën e hetimit të efektshëm lidhur me zhdukjen e bashkëshortit të ankueses, gjë e cila gjithashtu ka shkaktuar shqetësim dhe vuajtje mendore.

Paneli gjithashtu ka rekomanduar që unë të ndërmarr hapa të duhur lidhur me pagesën e kompensimit për ankuesin lidhur me dëmin moral, si dhe të ndërmarrë

hapa të duhur për realizimin e programit të plotë dhe gjithëpërfshirës të reparacioneve. Në këtë drejtim, dëshiroj të përkujtoj se veprimet në fjalë kanë të bëjnë me aktivitetet e institucioneve të themeluara në kuadër të administratës së përkohshme të Kosovës. Si të tilla, po qe se UNMIK-u edhe sot do të vazhdonte të ketë kontroll ndaj këtyre institucioneve, do të kishte qenë në pozitë që t'ia referojë rekomandimet e Panelit këtyre institucioneve në mënyrë që ato të ndërmarrin veprimet e duhura. Unë jam i gatshëm të diskutoj mundësinë e themelimit të mekanizmit për trajtimin e këtyre çështjeve me autoritetet përkatëse në rrethanat e duhura.

Në fund, përkritazi me rekomandimin e pestë lidhur me garancitë për mospërsëritje, dëshiroj të theksoj se UNMIK-u më nuk zbaton funksione policore, duke përfshirë edhe hetimet policore. Në këtë drejtim, dëshiroj të përkujtoj se Paneli është themeluar nga UNMIK-u me mandat për të shqyrtuar ankesat nga cilido person a grup i individëve që pretendojnë se kanë qenë viktimë e shkeljeve të të drejtave të tyre të njeriut nga ana e UNMIK-ut. Unë gjithashtu dëshiroj të përkujtojë se mandati i UNMIK-ut dhe, rrjedhimisht, mandati i PSSP-së, është i kufizuar në atë që parashihet në Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit, ashtu siç ka ndryshuar me kalimin e kohës sipas rrethanave të përcaktuara nga Këshilli i Sigurimit.

Thënë në përgjithësi, Panelin mund ta informojmë se organet kryesore të Organizatës së Kombeve të Bashkuara kanë miratuar rezoluta dhe vendime të shumta, përmes të cilave pasqyrohet rëndësia e avancimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe mbrojtjen e tyre nga Kombet Bashkuara. Organizata gjithashtu vazhdon të bëjë ndryshime me qëllim të fuqizimit të punës së saj për të ardhmen dhe brenda fushëveprimit të Organizatës Kombeve të Bashkuara, ku mund të bëjë ndryshime. Në këtë aspekt, do të vazhdojë përpjekjet e veta në plotësimin e misionit të vet për mbrojtjen e njerëzve nga dëmi”.

21. Në një datë të pasaktësuar më pas, ankuesja e ka adresuar çështjen në EULEX. Ajo u informua nga EULEX-i se akuza penale e regjistruar në Zyrën e Prokurorisë Speciale të Kosovës ishte hedhur poshtë për shkak të mungesës së provave në lidhje me autorët. Ajo u informua më tutje nga EULEX se rasti do të mbetej aktiv derisa të përcaktohej fati i bashkëshortit të saj.

IV. ANKESA

22. Ankuesja i referohet dy të drejtave themelore të caktuara të pasqyruara në dispozitat e mëposhtme: Nenit 2 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa), nën drejtimin e tij procedural, i cili garanton të drejtën themelore të njeriut për jetën dhe siguron për një detyrim për të hetuar rastet e vdekjeve të dyshimta; Nenit 3 të Konventës, i cili garanton të drejtën e personit për të mos iu nënshtruar torturës ose trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor ose poshtëruës.

23. Rasti u shpall gjithashtu i pranueshëm në lidhje me Nenin 8 dhe 13 të Konventës dhe të drejtat e garantuara në bazë të tij.
24. Të njëjtat të drejta themelore të njeriut garantohen nga një numër i traktateve të tjera ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike. Këto të drejta janë pjesë e një grupi thelbësor të të drejtave themelore të njeriut, të cilat janë të garantuara për të gjithë si një çështje e së drejtës ndërkombëtare zakonore.
25. Duke marrë parasysh marrëdhënien e ngushtë familjare ndërmjet viktimës së drejtpërdrejtë dhe ankueses, Paneli është i bindur që ankuesja mund të konsiderohet si viktimë dytësore e shkeljeve të supozuara dhe se si e tillë viktimë e mundshme në pajtim me rregullën 25(1) të rregullores së punës së Panelit. Paneli gjithashtu thekson në lidhje me këtë se neni 24(1) i Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukjet me Forcë thekson se “viktimë” për qëllimin e kësaj Konvente nënkuptohet personi i zhdukur dhe çdo individ që ka pësuar dëm si rezultat i drejtpërdrejtë i zhdukjes me forcë.

V. PARASHTRESAT E PALËVE

Ankuesja

26. Siç përmblihet më lartë, ankuesja pretendon se EULEX-i Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv duhej të kishte hetuar zhdukjen e bashkëshortit të saj dhe me faj nuk e ka bërë atë në kundërshtim me të drejtat themelore të tij dhe të bashkëshortit të saj.

Shefi i Misionit (“ShM”) në lidhje me pranueshmërinë

27. Parashtrësat e ShM-së lidhur me pranueshmërinë i janë dërguar Panelit më 22 maj 2018. Një numër parashtrësash të bëra në këtë kontekst janë relevante këtu dhe prandaj përsëriten për qëllimet e tanishme.
28. ShM-ja pohon se dosja që ka të bëjë me zhdukjen e viktimës ishte ofruar nga UNMIK-u tek EULEX-i diku nga fundi i vitit 2008 dhe fillimi i vitit 2009.
29. UNMIK-u që fillimisht kishte kryer një hetim të këtij rasti, kishte hapur një dosje të personave të zhdukur më 4 prill 2002. Një “raport hetimor Ante-Mortem” sugjeronte se UNMIK-u në një moment kishte biseduar me të.
30. Në një datë të pasaktësuar, ankuesja ka parashtruar një ‘Raport mbi akuzën penale ndaj kryesve të panjohur të veprave penale’ pranë Prokurorit Ndërkombëtar të Prokurorisë së Qarkut në Prizren.

31. Më 14 shtator 2008, rasti ishte rishikuar nga UNMIK-u dhe ishte përpiluar një 'Raport i shqyrtimit të analizës së rasti', duke treguar se rasti duhej të mbetej në pritje 'duke pritur informacione të mëtejshme'.
32. Vlerësimi fillestar i lëndës nga një prokuror i EULEX-it është bërë më 6 mars 2009.
33. Më 20 korrik 2009, prokurori i EULEX-it ka lëshuar një 'Kërkesë për t'i kryer hetimet' (PPP numër 150/09/UNMIK nr. CCIU 2005-00190).
34. Më 11 janar 2011, Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës të EULEX-it (NjHKL) ka shqyrtuar përsëri lëndën.
35. Më 3 dhjetor 2013, një prokuror i EULEX-it në PSRK ka shqyrtuar përsëri dosjen e lëndës dhe ka lëshuar 'Hedhje poshtë e raportit penal' bazuar në pikëpamjen se nuk kishte asgjë në dosjen e lëndës që mund të sugjeronte veprime të mundshme hetimore'.
36. Më 1 dhjetor 2015, Misioni ka pranuar një letër nga ankuesi, të datës 1 nëntor 2015.
37. Më 22 dhjetor, Misioni iu është përgjigjur letrës së parashtrueses së ankesës dhe i ka ofruar asaj një kopje të 'Hedhja poshtë raportit penal'. Dokumenti nuk ishte mundur të dërgohej me sukses. Dokumenti ishte ridërguar përmes zyrës së EULEX-it në Beograd dhe përfundimisht ishte dorëzuar më 31 dhjetor 2015.
38. Më 14 maj 2018, dosja e lëndës që lidhet me zhdukjen e z. Miladinović ishte transferuar në institucionet e Kosovës.
39. Dosja e lëndës e mbajtur nga EULEX-i nuk përmban asnjë indikacion se EULEX-i më tej kishte kontaktuar UNMIK-un pas marrjes së kësaj dosje. ShM-ja gjithashtu ka treguar se Misioni nuk ka kërkuar të kontaktojë ndonjë subjekt tjetër të përfshirë në këtë çështje (p.sh., KNKK-së, UNMIK-ut, etj.) me qëllim të marrjes së informacionit që mund të kenë në lidhje me këtë rast.
40. Nuk ka asnjë indikacion në të dhënat se Misioni ka kërkuar të kontaktojë ankuesen ose të afërmit e tjerë të viktimave gjatë hetimit të këtij rasti ose t'i mbante të informuar për këtë çështje. Misioni shpjegon se 'Hedhja e raportit penal' nuk i ishte dorëzuar parashtrueses së ankesës për shkak të 'situatës politike' 'në atë kohë dhe se dorëzimi i dokumenteve ku shënonte "Republika e Kosovës" ishte *de facto* e pamundur në atë kohë.
41. Paneli vëren se shënimet nuk sugjerojnë që EULEX-i ka intervistuar ose ka kërkuar të intervistonte ndonjë dëshmitar (potencial) në lidhje me atë rast.

Parashtresat e ankuesit mbi meritat e rastit

42. Në letrën e saj të datës 13 maj 2019, ankuesi në përgjigje të pyetjeve të Panelit tregon si në vijim. Së pari, ajo nuk ishte njoftuar për ndonjë përpjekje të bërë nga autoritetet vendore (të Kosovës) për të hetuar këtë rast. Së dyti, ankuesja përsërit se Misioni ka dështuar të përmbushë përgjegjësitë e veta në këtë rast dhe kështu ka shkelur të drejtat e saj sipas neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës. Ajo vëren, në veçanti:

"Nuk kam informata se EULEX-i ka marrë masa efektive për të siguruar që hetimi penal mbi zhdukjen e bashkëshortit tim të vazhdojë dhe se autorët e krimit të dalin para drejtësisë".

43. Së treti, në përgjigje të hetimit të Panelit për atë pikë, ajo pohon se zhdukja e bashkëshortit të saj i ka shkaktuar -

"Shqetësim i madh mendor me intensitet të lartë dhe kohëzgjatje të gjatë, dhe se për shkak të mungesës së veprimit që synon hetimin e zhdukjes së tij dhe ndëshkimin e autorëve, ende vazhdoj të vuaj shqetësime mendore. Bashkëshorti im i zhdukur më ka mbështetur, kështu që pas kësaj zhdukje kam humbur plotësisht sigurinë materiale dhe mjetet e mbështetjes".

44. Së fundi, ankuesja i kërkon Panelit të urdhërojë Misionin që –

"Publikisht ta pranoj përgjegjësinë për dështimin e tij për të kryer hetime efektive në lidhje me zhdukjen e bashkëshortit tim, si dhe për vuajtjen dhe vuajtjen mentale [që ajo] ka vuajtur, për të ndërmarrë veprime adekuate me qëllim kompensimin e dëmit moral që lidhet me shkeljet e konstatuara të Konventës dhe të ndërmarrin hapa adekuate drejt realizimit të një programi të plotë dhe gjithëpërfshirës të dëmshpërblimit".

Parashtresat e ShM-së mbi meritat e rastit

45. Parashtresat e shëfës së Misionit në lidhje me bazueshmërinë e këtij rasti u morën më 20 maj 2019. Në letrën e saj, ShM-ja thekson se nuk ka informata të mëtejshme të disponueshme për të dhënë në lidhje me pyetjet a-c të paraqitura nga Paneli në Vendimin e tij të pranueshmërisë (shih më lart paragrafi 6).

46. Pyetja e katërt e Panelit ishte si më poshtë: "Kur transferoheshin shkresat e lëndëve në institucionet e Kosovës, a ishte ndonjë material hetues i miratuar pranë autoriteteve vendore në lidhje me këtë rast? A ishte i informuar ankuesi për këtë transferim? ". Si përgjigje, Misioni përsëriti se i kishte dërguar të gjitha dokumentet në posedim lidhur me këtë rast tek autoritetet e Kosovës më 15 maj 2018. Misioni pastaj shpjegon edhe një herë procesin e shqyrtimit dhe dorëzimit të dosjeve të tilla. Në këtë rast specifik, ShM-ja shton:

"Dokumenti për transferimin e dosjeve përgatitur nga kryeprokurori i EULEX-it dhe i adresuar kryetarit të PSRK-së, tërhoqi vëmendjen në faktin se një dëshmitar i mundshëm në këtë rast nuk ishte intervistuar dhe rekomanduar si në vijim: që dëshmitari i përmendur [të gjendet] dhe të intervistohet; që faktet e përfshira në kallëzimet penale të kontrollohen hollësisht me dëshmi të disponueshme në dosje të tjera lidhur me veprat penale të ndërlidhura me kohën dhe aspektin gjeografik.

47. Misioni nuk specifikon se çfarë materiali dëshmuar, nëse ka, ishte transferuar si pjesë e dosjes. As nuk i drejtohet pyetjes së dytë të Panelit (d.m.th. nëse parashtruesi i ankesës ishte njoftuar për këtë transferim).

48. Në përgjigje të pyetjes së Panelit nëse Misioni po monitoronte këtë rast, ShM-ja është përgjigjur se Misioni "aktualisht nuk është duke e monitoruar këtë rast pasi që, për aq sa është në dijeni, rasti nuk është aktiv".

49. Duke trajtuar më në përgjithësi meritat e ankesës, Misioni thotë se -

"Nuk mund dhe nuk do të mohojë se mënyra e trajtimit të këtij rasti ishte ndikuar shumë nga sfidat e mëdha me të cilat ballafaqohej Misioni, në zbatimin e mandatit të tij ekzekutiv në fushën e krimeve të luftës dhe krime të tjera të rënda, që nga fillimi i ekzistencës së tij".

Këto sfida, që paraqet Misioni, nuk lidhen vetëm me madhësinë e detyrës, por edhe me numrin dhe gjendjen e dosjeve të lëndëve të marra nga UNMIK-u. Misioni shpjegon se dosjet e lëndëve të pranuar si "të mbyllura" nga UNMIK-u ishin ato "për të cilat mbetjet e të zhdukurve ishin gjetur në momentin e transferimit të dosjeve".

50. Misioni e përshkruan marrjen e dosjeve nga UNMIK-u me dokumente që mungojnë; materiale të pa-indeksuara; kopje të dokumenteve mezi të lexueshme; dhe bazat e të dhënave që nuk mund të kontrolloheshin me lehtësi. Si rezultat, Misioni ka përshkruar në disa hollësi kohën dhe përpjekjet e nevojshme që merr për të shqyrtuar dhe përpjekur për të organizuar atë informacion.

51. Misioni thekson atë që thotë se ishte një tjetër sfidë e madhe në lidhje me regjistrimet e trashëguara nga UNMIK-u, përkatësisht se "një numër i madh i dosjeve policore të krimeve të luftës që duhej të ishin raportuar pranë autoriteteve prokuroriale kompetente para dorëzimit në EULEX, ose që duhej të hidheshin poshtë për shkak të mungesës së provave, në të vërtetë ishin dorëzuar në stacionin e policisë edhe pse ishin kryesisht joaktive për një numër të konsiderueshëm vitesh ". Kjo e ka bërë të nevojshme që EULEX-i të shqyrtojë një numër të madh (1.200) të dosjeve policore të krimeve të luftës për të vendosur se cilat të hetoheshin dhe cilat të liheshin mënjanë.

52. Misioni përfundon si në vijim:

"Duke pasur parasysh sfidat e përshkruara më sipër dhe burimet e kufizuara në dispozicion, është e mundshme që gabimet dhe lëshimet mund të kenë ndodhur. Në këtë rast të veçantë, duke u njoftuar në lidhje me këtë, Misioni kërkoi të korrigojë gjendjen në momentin e dorëzimit të dosjes së lëndës në institucionet kompetente të Kosovës, siç është përshkruar më lart."

VI. SHQYRTIMET

Mandati ekzekutiv dhe përgjegjësitë e Misionit

53. Veprimet e prokurorëve dhe policisë së EULEX-it në parimin janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë në sektorët e drejtësisë, policisë dhe doganave. Prandaj, në parim ato bien në kuadër të mandatit të Panelit (shih, për shembull, *K-T kundër EULEX-it*, 2013-05 deri 2013-14, 21 prill 2015, paragrafi 43, *Krlić kundër EULEX-it*, 2012-21 , 26 gusht 2014, paragrafi 23; *Y kundër EULEX-it*, 2011-28, 15 nëntor 2012, paragrafi 35).
54. Paneli tashmë ka pasur rastin të theksojë se Misioni i EULEX-it nuk është shtet dhe se aftësia e tij për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut nuk mund të krahasohet në të gjitha aspektet përkatëse me atë që mund të pritet nga një shtet (shih vendimin e Panelit në *A, B, C, D kundër EULEX-it*, 2012-09 në 2012-12, 20 qershor 2013, paragrafi 50, *K-T kundër EULEX-it*, cituar më lart, paragrafi 53, krahasoni gjithashtu vendimin e PKDNJ-së në lëndët 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, paragrafi 35).
55. Pritjet e vendosura mbi aftësinë e EULEX-it për të hetuar dhe zgjidhur çështjet komplekse penale duhet të jenë realiste dhe të mos i ngarkojnë EULEX-it një barrë joproporcionale që mandati dhe burimet e tij nuk mund të priten t'i përmbushin në mënyrë të arsyeshme (LO kundër EULEX, 2014-32, dhe të gjeturat, 11 nëntor 2015, paragrafët 43 dhe 45, dhe referencat e tij në: Vendimin e Panelit në *A, B, C, D kundër EULEX-it*, 2012-09, 2012-12, 20 qershor 2013, para 50; kundër EULEX-it, 2013-05 në 2013-14, 21 prill 2015, paragrafi 53, krahasoni gjithashtu vendimin e PKDNJ-së në lëndët 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, paragrafi 35; në rastet 248/09, 250/09 dhe 251/09, të cituar më lart, paragrafi 70-71 Shih gjithashtu Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, Vendim për Pranueshmëri, 29 shtator 2015, paragrafët 35-37; DW, EV, FU, GT, Zlata Veselinovic, HS, IR kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, Vendim mbi pranueshmëri, 30 shtator 2015, paragrafët 72-74, shih gjithashtu vendimin e PKDNJ në lëndët 248/09, 25 0/09 dhe 251/09, cituar me lart, par. 70-71). Prandaj, në secilin rast, Paneli duhet të shqyrtojë nëse ka pasur pengesa konkrete dhe reale që mund të kenë dëmtuar kapacitetin e EULEX-it për të kryer një hetim të shpejtë dhe efektiv të një rasti. Një vlerësim i tillë nuk ka për qëllim të justifikojë mangësitë operationale që nuk lidhen me sfida konkrete dhe të demonstrueshme. Shih, përsëri, L.O. kundër EULEX-it, 2014-32, Vendimi dhe Gjetjet, 11 nëntor 2015, para. 44.
56. Në vlerësimin e kësaj ankese, Paneli ka marrë parasysh vështirësitë e përfshira domosdoshmërisht në hetimin e krimeve të luftës në një shoqëri pas konfliktit si Kosova

(shih L.O. kundër EULEX-it, 2014-32, 11 nëntor 2015, paragrafi 44 dhe referencat e përmendura aty, Palić kundër Bosnjë dhe Hercegovinës, aplikacioni 4704/04, aktgjykimi i 15 shkurtit 2011, paragrafi 70, vendimi i PKDNj-ja në lëndët 248/09, 250/09 dhe 251/09, cituar më lartë, paragrafët 44 dhe 62 e tutje). Megjithatë këto vështirësi nuk duhet të shërbejnë për të maskuar apo justifikuar dështimet hetimore që nuk janë në ndonjë mënyrë kuptimplotë të lidhur me vështirësitë e përmendura. Prandaj, Paneli do të vlerësojë në çdo rast nëse një hap i veçantë hetimor që normalisht ishte i hapur për EULEX-in do të ishte bërë jopraktik nga arsyet që lidhen me rrethanat pas konfliktit, të pavarura nga ata që kryejnë hetimin (L.O. kundër EULEX-it, 2014-32, Vendim dhe Gjetjet, 11 nëntor 2015, paragrafi 44).

57. Veçanërisht relevante në vlerësimin e përgjigjes së Misionit është fakti se aftësia e tij për të përmbushur detyrimet e veta hetimore është ndikuar nga të dy rrethanat e përgjithshme në të cilat ishin kryer krimet dhe nga sjellja e UNMIK-ut pas këtyre krimeve. Krimet e kryera në kontekstin e një konflikti të armatosur janë pothuajse gjithmonë një sfidë për të hetuar. Sfida shpesh mbetet menjëherë pas një konflikti, sepse dëshmitë mund të shkatërrohen ose të kufizohen në natyrë dhe gatishmëria ose aftësia e dëshmitarëve për të dhënë informacion mund të reduktohet ndjeshëm për shkak të rrethanave të sigurisë. Paneli ka marrë në konsideratë këto sfida gjatë marrjes së vlerësimit ndaj përgjigjes së Misionit.
58. Paneli gjithashtu ka marrë parasysh faktin se EULEX-i Kosovë duhej të përballëj dhe të trajtojë trashëgiminë hetimore të UNMIK-ut. Paneli nuk është i autorizuar të shqyrtojë ose të vlerësojë veprimet e UNMIK-ut. Këtë e bën vetëm këtu, për aq sa ka ndikuar në punën e Misionit. Është me të vërtetë e qartë nga parashtrimet e Misionit - dhe nga procesverbalet e rasteve të tjera që kanë ardhur pranë Panelit - që ruajtja dhe transferimi i dosjeve të UNMIK-ut në Mision ishte pak se e mjaftueshme dhe e kishte bërë punën e Misionit edhe më të komplikuar në lidhje me hetimin e rasteve të regjistruara në ato dosje. Prandaj Paneli nuk do t'i ngarkoj Misionit mangësitë dhe defektet të shkaktuara nga veprimet e UNMIK-ut dhe do të jetë i kujdesshëm për të kufizuar vlerësimin e tij në veprimet e Misionit.
59. Në çdo rast, në rastet e veçanta të këtij serioziteti, autoritetet hetimore pritet të veprojnë me kujdes dhe shpejtësi të arsyeshme dhe të investojnë burime në përputhje me domosdoshmërinë dhe mundësinë për zgjidhjen e lëndës. Përderisa asnjë autoritet hetues nuk mund të pritët të zgjidhë të gjitha rastet e paraqitura përpara tij, pritët të veprojnë me një kujdes të tillë, shpejtësi dhe efektivitet, duke pasqyruar rëndësinë e çështjes nën hetim (L.O. kundër EULEX-it, 2014-32, Vendimi dhe gjetjet, 11 nëntor 2015, paragrafët 46 dhe 59, dhe referenca e tyre në GjEDNj: Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë, aplikacioni nr.16064 / 90 e tutje, aktgjykimi i 18 shtatorit 2009, paragrafi 191, Palić kundër Bosnjë dhe Hercegovinës, 4704/04, aktgjykimi i datës 15 shkurt 2011, paragrafi 63).
60. Një angazhim dhe lidhje e rreptë ndaj këtyre standardeve është veçanërisht e rëndësishme për një mision të sundimit të ligjit që synon të shërbejë si një shembull i angazhimit të shoqërisë për t'i dhënë fund mosndëshkimit dhe për të ndërtuar në të një ndjenjë përgjegjësie ndaj shkeljeve të rënda të të drejtave. Çdo standard që është më pak se ai që

u përmend më sipër do të rrezikonte të krijonte një ndjenjë të pranimit të mosndëshkimit dhe mosrespektimit të kërimit të drejtësisë dhe llogaridhënies ndaj viktimave (L.O. kundër EULEX-it, 2014-32, Vendimi dhe Gjetjet, 11 nëntor 2015, paragrafi 46 dhe referenca në GjEDNj: Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë, aplikacioni nr.16064/90 e tutje, aktgjykim i 18 shtatorit 2009, paragrafi 191, Palic kundër Bosnjë dhe Hercegovinës, aplikacioni 4704/04, aktgjykimi i 15 shkurtit 2011, paragrafi 63); Vendimi i PKDNj-së në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, para. 80.); Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, Vendimet dhe të gjeturat, 19 tetor 2016, par. 37; shih gjithashtu vendimin e PKDNj-së në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, cituar më lart, par. 80).

61. Sa i përket çështjes së shpejtësisë, Paneli dëshiron të theksojë si më poshtë. Lidhur me detyrimet e tij hetuese, Misioni kërkohet të hetojë dyshimet e besueshme ndaj shkeljeve të drejtave të njeriut me kujdes dhe shpejtësi dhe për të siguruar në të gjitha rastet se reagimi hetimor i Misionit është në përpjesëtim me rëndësinë e çështjes. Në përgjithësi, përgjigja duhet të jetë e tillë që të garantojë mbrojtjen efektive të të drejtave në fjalë. Shih, në përgjithësi, Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, 19 tetor 2016, par. 36. Gjithashtu shih Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë, Kërkesa nr. 16064/90 e tutje, aktgjykimi i 18 shtatorit 2009, par. 191; Oğur kundër Turqisë, Kërkesa nr. 21594/93, aktgjykimi i 20 majit 1999, par. 88; Hugh Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa nr. 24746/94, Aktgjykimi i 4 majit 2001, par. 105-09; Douglas-Williams kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa nr. 56413/00, vendimi i 8 janarit 2002. Kur detyrimi i shtetit ose autoritetit përfshin detyrim për të hetuar, kriteri për shpejtësi duhet të zbatohet në të gjitha fazat dhe aspektet e hetimit: nxitjes së tij, sjelljes së tij dhe kryerjes së tij. Kriteri për shpejtësi është relative për nga natyra: varet nga rrethanat e secilit rast veç e veç, në veçanti prej sfidave të paraqitura nga rasti, vështirësitë për t'iu qasur dëshmitarëve ose mbledhjes së informacionit. Por sfidat dhe vështirësitë hetimore nuk i arsyetojnë zvarritjet, vonesat apo ngadalësimet e pajustificueshme në kryerjen e detyrave hetimore. Kjo është një deklaratë e së drejtës më të gjerë për procedim pa vonesa të panevojshme, që u garantohet të gjitha palëve në procedurë. Paneli ka theksuar kështu se -

"E drejta për një dëgjim të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme siç kuptohet sipas nenit 6(1) të Konventës është hartuar për të mbrojtur" të gjitha palët në procedurat gjyqësore ... ndaj vonesave të tepruara procedurale ... Përveç kësaj, në rastet penale, e drejta është e projektuar në atë mënyrë për të shmangur që personi i akuzuar të mbetet tepër gjatë në gjendje të pasigurisë lidhur me fatin e tij "[...]" (Maksutaj kundër EULEX-it, 2014-18, 12 nëntor 2015, paragrafi 57, citatet janë nga Stogmuller kundër Austrisë, aplikacioni nr.1602/62, aktgjykimi i datës 10 nëntor 1969, paragrafi 5).

Në një rast të veçantë, në vlerësimin e arsyeshmërisë së kohës që merret nga autoritetet, janë identifikuar një numër faktorësh si veçanërisht të rëndësishëm, duke përfshirë këto: "Gjatë shqyrtimit të arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës, Panelit i kërkohet të shqyrtojë rrethanat e rastit dhe i konsiderojnë këta faktorë si të rëndësishëm për atë vlerësim: (1) kompleksitetin e çështjes, (2) sjelljen e aplikantit dhe: (3) sjelljen e

administratës kompetente [...]” Maksutaj kundër EULEX-it, 2014-18, 12 nëntor 2015, paragrafi 58, dhe referencat e tij ndaj Konig kundër FRG, aplikacioni 6232/73, aktgjykimi i 28 qershorit 1978, paragrafi 99, Pedersen dhe Baadsgaard kundër Danimarkës, aplikacioni nr. 49017/99, gjykimi i 17 dhjetorit 2004, paragrafi 45; shih gjithashtu, Thomas Rüsche kundër EULEX-it, 2013-21, 11 janar 2017, paragrafët 59-65). Një shqyrtim i pasojës së vonesave për palët e përfshira mund të ofroj po ashtu dëshmi relevante për arsyeshmërinë ose ndryshe për vonesat në proces (Maksutaj kundër EULEX-it, 2014-18, 12 nëntor 2015, paragrafi 64-66 dhe referencat e cituara).

62. Duhet gjithashtu të theksohet për qëllimet këtu se të drejtat që i nënshtrohen kësaj ankese janë ndër të drejtat më të rëndësishme prej të gjitha të drejtave themelore. Ato prekin interesat thelbësore të viktimave të supozuara dhe duhet të garantohen në të gjitha rrethanat. Praktika e zhdukjes me forcë përbën një shkelje të egër të këtyre të drejtave. Kjo reflektohet, ndër të tjera, në faktin se tani konsiderohet dhe karakterizohet si një krim kundër njerëzimit, në veçanti, në Statutin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale (Statuti i Romës, neni 7(1)(i)) dhe në Ligji mbi Dhomat e Specializuara dhe Prokuroria e Specialistëve (Ligji nr. 05/L-053) (Neni 13(1)(i)).
63. Implikimet e ndryshimeve në mandatin e Misionit pas përfundimit të mandatit ekzekutiv të Misionit në qershor të vitit 2018 dhe implikimet e tyre për qëllimin e këtij rasti trajtohen shkurtimisht më poshtë.

"Zhdukja me forcë" si një shkelje e rëndë e të drejtave themelore të viktimave

64. Praktika e zhdukjes me forcë është një nga shkeljet më të egra të të drejtave të njeriut. Ato përfshijnë shkeljen e jo një të drejte, por shumë, duke përfshirë në shumë raste, të drejtën për të vërtetën, të drejtën e njohjes si person para ligjit, të drejtën për liri dhe sigurinë e personit dhe të drejtën për të mos iu nënshtuar torturës dhe trajtimit ose dënimit tjetër të egër, çnjerëzor ose poshtërues, të drejtën për një zgjidhje efektive dhe një sjellje të tillë cenon ose përbën një kërcënim të rëndë për të drejtën e jetës. Shih, p.sh., Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, Vendimi dhe Gjetjet, 19 tetor 2016, par. 33; Deklarata për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me forcë (A/RES/47/133, 18 dhjetor 1992).
